

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6747
E mërkurë, 2 nëntor 2022
çmimi 0.40 €

Nënoficerët e FSK-së
fillojnë sfidën për t'u
bërë oficerë | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) KËRKOJNË SHTYRJE
TË PLOTË TË AFATIT PËR TARGAT | FAQE 4-5

SHBA-ja: I KËRKUAM KOSOVËS SHTYRJE TË PLOTË E JO TË PJESSHME TË VENDIMIT PËR TARGAT



Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë reaguar sërish në lidhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës për çështjen e targave i cili nis me gjoba prej 21 nëntorit për qytetarët serbë që nuk konvertojnë targat e makinave të tyre. Zëdhënësi i

Departamentit të Shtetit, Ned Price, ka theksuar se Shtetet e Bashkuara janë të zhgënjyera dhe të shqetësuara që Qeveria e Kosovës refuzoi kërkesën dhe këshillën e partnerëve të saj më të ngushtë

AKTUALE



"NXJERRJA E PROVAVE" DISKUTOHET
NË KONFERENCËN E RADHËS NDAJ
LIDERËVE TË UÇK-së | F. 5

BORDI I AKP-SË VENDOS PËR
SHITJE 31 ASETË TË NDËRMARRJEVE
SHOQËRORE | F. 6

SHËNDETËSIA, ARSIMI, MBROJTJA
E BUJQËSIA VAZHDOJNË TË
JENË PRIORITETET E QEVERISË | F. 7

EKONOMI



RIZVANOLLI NUK E PËRJASHTON
MUNDËSINË E RITJES SË ÇMIMIT
TË RRYMËS | F. 8

KËRKOHET TERMINAL I RI DOGANOR
NË VENDKALIMIN KUFITAR
JAZHINCË - GLLBOÇICË | F. 8


SPORT



GJIMNASTET PËRFAQËSOJNË
KOSOVËN NË PORTUGALI | F. 10



NAGAVCI:
KEMI
NDËRMARRË
NJË VARG
MASASH
PËR TA
PËRMIRËSUAR
GJENDJEN
NË ARSIM | FAQE 3



RRETH 100 MIJË SHQIPTARË
NË LUGINË TË PRESHEVËS | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Policia jugkoreane merr përgjegjësinë për tragjedinë në festën e Halloweenit



SEUL, 1 NËNTOR - Shefi i Policisë në Korenë Jugore, Yoon Hee-keun, e ka pranuar që zyrtarët policorë nuk kanë vepruar në mënyrë adekuate në incidentin e 29 tetorit, në të cilin si pasojë e shtypjes kanë vdekur qindra persona. Kjo ka qenë hera e parë që zyrtarët e kanë pranuar se nuk kanë bërë mjaftueshëm për ta parandaluar incidentin, që ka lënë të vdekur 155 persona

dhe të plagosur 152 të tjerë. Sipas Yoon, përgjigjja e policisë ka qenë "zhgënjyese" dhe se ai ka ndier "përgjegjësi të pakufishme për sigurinë publike" lidhur me atë që ka ndodhur dhe është zotuar për hetim të plotë. Incidenti ka ndodhur në mbrëmjen e së shtunës pasi një numër i madh njerëzish janë mbledhur në një lagje të Seulit për ta festuar Natën e

Shtirigave (Halloween). Kjo ka qenë hera e parë që kjo festë është shënuar pa kufizime kundër koronavirusit. Yoon ka thënë se policia ka pranuar disa thirrje para se të ndodhte aksidenti, me paralajmërimet se situata është serioze, mirëpo reagimi ka munguar. Ai i ka bërë këto komente teksa po rritet kërkesa e publikut për llogaridhënie.

Një miliardë heq dorë nga shtetësia ruse për shkak të luftës në Ukrainë

MOSKË, 1 NËNTOR - Miliarderi rus Oleg Tinkov ka hequr dorë prej shtetësisë ruse për shkak të luftës së nisur nga Moskë në Ukrainë. Ai, po ashtu, ka dënuar "fashizmin e Putinit", duke iu referuar presidentit rus Vladimir Putin. Tinkov e ka themeluar bankën online "Tinkoff", një prej ofruesve më të mëdha të kredive. Aktualisht kjo bankë ka mbi 20 milionë konsumatorë. Përmes një postimi në "Instagram", ai ka thënë se "nuk mund të jem i lidhur me një shtet fashist që ka nisur luftë kundër fqinjit paqësor". Edhe disa manjatë të tjerë rusë e kanë kritikuar publikisht luftën e Rusisë në Ukrainë.

"Është e turpshme për mua që të vazhdoj të mbaj këtë pasaportë", ka thënë miliarderi. Ai besohet se aktualisht jeton në Londër, mirëpo është subjekt i sanksioneve të Mbretërisë së Bashkuar, sikurse shumë anëtarë të elitës biznesore ruse. "Shpresoj që më shumë biznesmenë do të jenë pas meje, në mënyrë që ta dobësojnë regjimin e Putinit dhe ekonominë e tij, dhe që në fund ai të humbë", ka thënë Tinkov. Ai ka thënë se e urren Rusinë e Putinit, mirëpo i do të gjithë rusët që janë kundër luftës. Sanksionet perëndimore ndaj tij, dhe figurave të tjera biznesore të Rusisë - të njohur si



oligarkë - përfshijnë ndalesa në udhëtime, ngrirje të aseteve dhe konfiskim të aeroplanëve dhe

jahteve. Fuqia politike dhe ushtarake e Putinit varet shumë nga

mbështetja e miliardërve të cilët janë pasuruar përmes lidhjeve me Kremlinin.

Polonia arrin marrëveshje për ndërtimin e uzinës së dytë bërthamore



VARSHAVË, 1 NËNTOR - Varshava dhe Seuli kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi që kompania jugkoreane KHNP ta ndërtojë uzinën e dytë bërthamore të Polonisë. Ky njoftim vjen tri ditë pasi kryeministri polak Mateusz Morawiecki tha se kompania amerikane Westinghouse u zgjodh për ta ndërtuar uzinën e

parë bërthamore të shtetit në Çozevo në Detin Baltik. Marrëveshja është midis KHNP-së dhe partnerëve nga Polonia PGE dhe ZE Pak dhe qeverisë polake. Kjo uzinë është paraparë të ndërtohet në Patnov. Qeveria e Polonisë pritet të diskutojë gjatë kësaj jave sa i përket programit civil bërthamor të shtetit.

Varshava për vite të tëra ka planifikuar një program, por çështjet e sigurisë energjetike kanë shtuar urgjencën e një programi civil bërthamor pas tensioneve me Rusinë lidhur me pushtimin e saj të Ukrainës. Uzina për prodhimin e rrymës nga kompania amerikane Westinghouse parashihet të nisë më 2033.

Elon Musk shkarkon bordin e drejtorëve të "Twitter"-it

SAN FRANCISCO, 1 NËNTOR - Miliarderi Elon Musk e ka shkarkuar bordin e drejtorëve të platformës "Twitter". Musk tani do të jetë shefi ekzekutiv i kompanisë, pas blerjes së platformës javën e kaluar në vlerë të 44 miliardë dollarëve. Përveç "Twitter"-it, Musk është shef ekzekutiv edhe i dy kompanive të tjera, "Tesla" dhe "SpaceX".

Ai ka nisur të kryejë reforma menjëherë në këtë rrjet social, të cilin e përdorin politikanë dhe gazetarë në gjithë botën. Në mesin e reformave përfshihen ndryshime në verifikim të llogarive në "Twitter" si dhe zvogëlim të vendeve të punës. E përditshmja amerikane "The Washington Post" ka raportuar se është duke u diskutuar zvogëlimi i 25 për

qind të numrit të punëtorëve. "Twitter" nuk ka reaguar lidhur me këto raportime. Më vonë, vetë Musk ka thënë se vendimi për shpërbërje të bordit të drejtorëve është hap "i përkohshëm", por pa dhënë më shumë hollësi. Aktualisht Elon Musk është njeriu më i pasur në botë, me një pasuri prej më shumë se 269 miliardë dollarësh, sipas revistës "Forbes".



Nënoficerët e FSK-së fillojnë sfidën për t'u bërë oficerë

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Në kuadër të trajnimeve dhe shkollimeve që Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) ofron, të martën në Kazermën "Adem Jashari" në Prishtinë ka filluar realizimi i kursit bazik të oficerit në kuadër të Shkollës së Oficerëve të Akademisë së Mbrojtjes.

Pjesëmarrës të këtij kursi janë nënoficerët të FSK-së, të cilët, pas përfundimit me sukses, do të kalojnë në pozita komanduese në gradën e nëntogerit.

Kursi bazik i oficerit i trajnon kandidatët e përzgjedhur në aftësitë e udhëheqjes ushtarake, vlerëson

potencialin e lidërshiptit dhe kualifikon kandidatët me gradën nëntoger në FSK. Kjo është hera e parë që Forca e Sigurisë së Kosovës organizon Kursin Bazik të Oficerit me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale sipas Planit Gjithpërfshirës të Tranzicionit (PGJT).



Nagavci: Kemi ndërmarrë një varg masash për ta përmirësuar gjendjen në arsim

Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, gjatë raportimit në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike në lidhje me raportin e auditimit për pasqyrat vjetore financiare të MASHTI-t për vitin 2021, ka theksuar se si ministri dhe qeveri kanë ndërmarrë një varg masash për ta përmirësuar gjendjen në arsim

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka raportuar të martën në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike në lidhje me raportin e auditimit për pasqyrat vjetore financiare të MASHTI-t për vitin 2021 si dhe për raportimin e auditimit "Vlerësimi i nxënësve në testet ndërkombëtare dhe kombëtare".

Ajo ka thënë se raporti i auditimit për vitin 2021 dëshmon se performanca

financiare ka qenë dukshëm më e mirë se në vitet paraprake. "Për vetëm një vit punë kemi arritur t'i zbatojmë në tërësi 15 rekomandime të vitit paraprak. Po ashtu, në krahasim me vitin e kaluar, është përgjysmuar numri i rekomandimeve. 22 rekomandime ishin në vitin 2020, 11 rekomandime për vitin 2021", ka thënë Nagavci.

Ajo ka shtuar se në çështjet e adresuara në raportin e vitit 2021 pjesa më e madhe e rekomandimeve janë çështje që nuk varen drejtpërdrejt nga MASHTI, por edhe nga institucionet e linjës. "Disa



nga to janë edhe për shkak të problemeve të identifikuar", është shprehur ministrja Nagavci.

Ajo anëtarët e komisionit i ka informuar se MASHTI tashmë ka përgatitur planin e veprimit të cilin do ta

adresojë këtë vit në mënyrë që vitin e ardhshëm të ketë performancë edhe më të mirë. "Sa i përket raportit të auditimit për 'Vlerësimin e nxënësve në testet ndërkombëtare dhe kombëtare', rezultatet në arsim nuk janë ende ato që i dëshirojmë. Pas analizimit të raportit, por edhe të vetëdijshëm për nevojën e investimit shumëdimensional për përmirësim të rezultateve dhe të cilësisë në arsim, jemi duke punuar me intensitet të shtuar e angazhim maksimal: kemi rritur buxhetin për arsim, jemi duke përmirësuar infrastrukturën ligjore e fizike, së fundi miratuar edhe Strategjinë për arsim 2022-2026. Pra, si Ministri e Arsimit dhe si qeveri kemi ndërmarrë një varg masash me të cilat synojmë t'i përmirësojmë rezultatet në arsim", ka thënë Nagavci.

Nis plotësim-ndryshimi i Ligjit për Noterinë



PRISHTINË, 1 NËNTOR - Është mbajtur takimi i parë i grupit punues për hartimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Noterinë. Ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, në fjalën e saj përshëndeti fillimin e punës së grupit punues, me ç'rast falënderoi pjesëmarrësit në këtë proces, posaçërisht Odën Federale të Noterëve në Gjermani, për bashkëpunimin dhe kontributin për përmirësimin dhe avancimin e kornizës ligjore të sistemit noterial të Republikës së Kosovës.

Më tej, ministrja Haxhiu theksoi se me qëllim të forcimit të

mëtejshëm të shërbimit të noterisë, është e rëndësishme që korniza ligjore të jetë e përshtatshme dhe t'u mundësojë qytetarëve qasje sa më të lehtë në shërbime noteriale dhe këto shërbime të jenë sa më cilësore dhe të ofruara me shumë përgjegjësi e profesionalizëm.

Në ligjin aktual për noterinë janë identifikuar në praktikë vështirësi që ndërlidhen me çështje të ndryshme të sistemit të noterisë që përfshijnë kushtet për ushtrimin e detyrës së noterit, kushtet dhe organizimi i provimit për noterinë, territori zyrtar dhe shërbimet noteriale elektronike.

Komandanti i KFOR-it viziton Manastirin e Deçanit

DEÇAN, 1 NËNTOR - Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Angelo Michele Ristuccia, ka vizituar Manastirin e Deçanit. Në njoftimin e KFOR-it theksohet se gjatë takimit të tij me igumenin e Manastirit, Sava Janjiq, gjenerali Ristuccia

ka theksuar përkushtimin e KFOR-it për ta mbështetur paqen, bashkëpunimin dhe përparimin për të gjithë njerëzit që jetojnë në Kosovë, siç është përshkruar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të

Bashkuara të vitit 1999.

Komandanti i KFOR-it, gjithashtu, ka theksuar rëndësinë e të gjitha bashkësive fetare për promovimin e paqes, tolerancës dhe respektit reciprok.





SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) KËRKOJNË SHTYRJE TË PLOTË TË AFATIT PËR TARGAT

ShBA-ja: I kërkuam Kosovës shtyrje të plotë e jo të pjesshme të vendimit për targa

Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë reaguar sërish në lidhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës për çështjen e targave i cili nis me gjoba prej 21 nëntorit për qytetarët serbë që nuk konvertojnë targa e makinave të tyre. Zëdhënësi i Departamentit të Shtetit, Ned Price, ka theksuar se Shtetet e Bashkuara janë të zhgënjyera dhe të shqetësuara që Qeveria e Kosovës refuzoi kërkesën dhe këshillën e partnerëve të saj më të ngushtë

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Zëdhënësi i Departamentit Amerikan të Shtetit, Ned Price, ka thënë se Shtetet e Bashkuara dhe komuniteti ndërkombëtar i kanë kërkuar Kosovës shtyrjen prej dhjetë muajsh të vendimit për konvertimin e targave të makinave dhe jo shtyrje të pjesshme. "Ne kemi qenë të qartë, publikisht dhe privatisht, se komuniteti ndërkombëtar,

përfshirë Shtetet e Bashkuara, kërkon një shtyrje të plotë të zbatimit të këtyre çështjeve. Ne nuk kërkojmë një shtyrje të pjesshme, nuk kërkojmë zbatim në fazë. Komuniteti ndërkombëtar i ka kërkuar Qeverisë së Kosovës një shtyrje të plotë", ka thënë ai, duke theksuar se po vazhdojnë diskutimet me palët në rajon dhe me Bashkimin Evropian. Zëdhënësi Price ka ritheksuar të hënën, në një konferencë me gazetarë, se Shtetet e Bashkuara

janë "të zhgënjyera" dhe "të shqetësuara" që Qeveria e Kosovës refuzoi kërkesën dhe këshillën e partnerëve të saj më të ngushtë sa i përket zbatimit të vendimit.

Edhe Bashkimi Evropian ka shprehur zhgënjimin që Qeveria e Kosovës nuk dëgjo këshillat e bllokut dhe të Shteteve të Bashkuara për zgjatjen e afatit për konvertimin e targave të makinave të lëshuara nga Serbia me ato të Kosovës.

Në një komunikatë të BE-së thuhet se Kosova ka të drejtë t'i heqë gradualisht targa e vjetra, "por procesi duhet të zhvillohet në mënyrën e dakorduar në dialog dhe të zbatohet në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe konsultative".

Ndonëse vendimi është një hap në drejtimin e duhur, thuhet në komunikatë, ai nuk është në përputhje me marrëveshjet e

dialogut, të cilat janë të detyrueshme për të dyja palët". Më tej, komunikata thekson se marrëveshja e vitit 2016 parashikonte një proces të renditur dhe të përcaktuar qartë me një afat kohor 12-mujor për procesin e konvertimit "i cili nuk është ndjekur". "Kosova duhet të lejojë një periudhë më të gjatë tranzicioni. Kjo ka qenë këshilla e vazhdueshme e partnerëve më të afërt të Kosovës, përfshirë BE-në dhe Shtetet e Bashkuara. Është zhgënjyese të shohësh se nuk është ndjekur këshilla", thuhet në komunikatë.

Bashkimi Evropian nënvizon se është e domosdoshme ruajtja e qetësisë. "Ne u bëjmë thirrje të gjitha palëve të përfshira që të ushtrojnë përmbajtje dhe të shmangin çdo veprim apo retorikë që mund të rrezikojë qëndrueshmërinë në terren, veçanërisht në veriun e

Kosovës".

Më 1 nëntor Qeveria e Kosovës ka nisur zbatimin e planit për reregjistrimin e makinave me targa të tilla që i lëshon Serbia. Llogaritet se janë rreth 10 000 automjete me targa që Kosova i konsideron të paligjshme dhe ato qarkullojnë kryesisht në veriun e Kosovës të banuar me shumicë serbe.

Plani i Qeverisë së Kosovës për reregjistrimin e tyre me targa RKS, apo Republika e Kosovës, do të zhvillohet në tri faza. Faza e parë përfshin qortimin e shoferëve, e dyta parasheh gjobë deri në 150 euro për ata shoferë, e treta targa provuese. Zbatimi i këtij plani pritet të përfundojë më 21 prill dhe, nga ajo datë, në qarkullim do të lejohen vetëm makina me targa RKS.

Serbia, e cila ushtron kontroll mbi serbët në veri, i kundërshton ato dhe insiston

“Nxjerrja e provave” diskutohet në konferencën e radhës ndaj liderëve të UÇK-së

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Të premten (më 4 nëntor) do të mbahet konferenca e 15 mbi ecurinë në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit në Hagë. Në bazë të vendimit të gjyqtarit paraprak mbi caktimin e kësaj konference është bërë me dije se në këtë konferencë do të diskutohet për nxjerrjen e provave, përkthimet, hetimet e mbrojtjes dhe hapat e mëtutjeshëm dhe çështje të tjera. Sa i përket nxjerrjes së provave do të kërkohet të dihet nëse është bërë progres në procesin e zbulimit në lidhje me materialin e rregullës 107, në veçanti sa nga ky material mbetet për t'u pastruar dhe nëse ndonjë aplikim shtesë në përputhje me këtë rregull është i pashmangshëm, raporton

“Betimi për Drejtësi”. Lidhur me përkthimet, gjykatësi paraprak ka kërkuar të informohet nëse administrata mund të sigurojë një përditësim për përkthimet e pazgjidhura, në veçanti përparimin e përkthimit të aktakuzës së ndryshuar më tej dhe grafikut të rregullës 109 (c) dhe plotësimit të tij. Ndërsa sa iu përket hetimeve të mbrojtjes dhe hapave të mëtejshëm do të kërkohet të dihet nëse mbrojtja mund të japë më shumë informacion mbi statusin e hetimeve të tyre, veçanërisht çfarë hapash kanë ndërmarrë për t'i çuar përpara hetimet e tyre. “Nëse ka pasur ndonjë përparim në lidhje me diskutimet mbi pikat e marrëveshjes mbi ligjin dhe/ose

faktet, në përputhje me rregullat 95 (3) dhe 156 të rregullave, dhe nëse palët parashikojnë ndonjë vështirësi në paraqitjen e njoftimeve deri më 18 nëntor 2022 dhe nëse mbrojtja parashikon ndonjë vështirësi në paraqitjen e njoftimeve në lidhje me kundërshtimet e tyre, nëse ka në këtë fazë të procedurës, për pranueshmërinë e materialit provues të zbuluar, në përputhje me rregullën 95 (2) (e) të rregullave, deri më 18 nëntor 2022”, është thënë në vendimin e gjyqtarit të Gjykatës Speciale. Më tutje është thënë se do të kërkohet të dihet nëse Zyra e Prokurorit të Specializuar parashikon ndonjë vështirësi për sigurimin e listës së 40 dëshmitarëve të parë që synon të

thërrasë në gjyq deri më 18 nëntor 2022. “Lidhur me rregullat 153, 154 dhe 155 të rregullores vihet re se ka dëshmitarë që kanë dhënë disa deklarata dëshmitarësh, a do të ishte ZPS në gjendje të tregojë (nëpërmjet ERN-së së dokumentit) se cilën deklaratë (at) synon ta ofrojë për praninë sipas këtyre rregullave dhe nëse palët parashikojnë ndonjë vështirësi në transferimin e kësaj çështjeje në një trup gjykues rreth fundit të vitit dhe nëse palët parashikojnë ndonjë vështirësi për t'u paraqitur para një trupi gjykues menjëherë pas dorëzimit të çështjes”, është thënë në këtë vendim. Në fund të vendimit është thënë se palët dhe pjesëmarrësit ftohen të tregojnë nëse parashikojnë nevojën për një konferencë në

dhjetor përpara transferimit të çështjes në një trup gjykues. Zyra e Prokurorit të Specializuar më 30 shtator ka dorëzuar aktakuzën e konfirmuar të ndryshuar ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, e cila përbëhet nga dhjetë pika. Ata janë duke u akuzuar kinse për krime lufte, por nga fillimi janë deklaruar të pafajshëm në raport me të gjitha akuzat që rëndojnë mbi ta. Thaçi, Veseli, Krasniqi dhe Selimi janë duke u mbajtur në paraburgim që nga nëntori i vitit 2022, pavarësisht se disa herë kanë kërkuar që të mbrohen në liri. Përpos tyre, në Hagë janë duke u mbajtur në paraburgim edhe Sali Mustafa, Hysni Gucati, Nasim Haradinaj dhe Pjetër Shala.



në targa neutrale ndaj statusit të Kosovës. Ministri i Mbrojtjes i Serbisë, Millosh Vuçević, ka thënë të martën se ushtria serbe është vënë në gjendje gatishmërie për shkak të situatës në Kosovë. Ai ka theksuar se urdhër për këtë ka dhënë presidenti i këtij vendi, Aleksandër Vučić. Vuçević nuk dha detaje se përse është marrë ky vendim dhe përse lidhet me situatën në Kosovë. Ndërsa partitë opozitare në Kosovë kritikuan qeverinë e vendit për, siç thanë, dëmtimin e interesave strategjike të vendit

duke mos përfillur kërkesat e aleatëve në një periudhë kur janë shtuar përpjekjet për ta çuar përpara procesin e normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet të dyja vendeve. Ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se vendimi i Kurtit për targarat është i paharmonizuar dhe i pakonsultuar me aleatët perëndimorë, posaçërisht me ShBA-në. Ai ka thënë se është një vendim shkurtpamës i cili mund të jetë edhe me pasoja për vendin. “Është e papranueshme kur ne u kërkojmë demokracive më të

fuqishme të Botës të na ndihmojnë t'u japim fund mosmarrëveshjeve shekullore me Serbinë, dhe pikërisht kur ato janë në kulmin e angazhimit, kryeministri ynë vepron krye në vete e pa koordinim me partnerët strategjikë. Nuk mund t'u kërkojmë vendeve mike ndihmë e të mos i përfillësh këshillat e tyre, aq më tepër kur ato jo vetëm se të kanë marrë nën mbrojtje, por falë edhe angazhimit të tyre Kosova sot është e lirë dhe e pavarur. Kjo është në kundërshtim edhe me traditën shqiptare”, ka thënë

Haradinaj. Ai ka theksuar se kryeministri Kurti duhet t'i analizojë mirë hapat e tij dhe në këtë fazë jetike për vendin duhet të jetë në harmoni të plotë me Amerikën dhe BE-në. “Andaj, i kërkoj ta rishikojë edhe vendimin për targarat. Dua të besoj se zhgënjimi i shprehur i partnerëve tanë me këtë vendim të kryeministrit nuk do të ketë pasoja për marrëdhëniet e shkëlqyera që ka Kosova me ta”, ka deklaruar lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj. Duke folur rreth vendimit të Qeverisë së Kosovës për targarat,

ish-ministria e Punëve të Jashtme, Meliza Haradinaj-Stublla, ka theksuar se presionin asimetrik ndërkombëtar ndaj saj, Kosova mund ta përballojë e ta tejkalojë vetëm me unitet politik përballë Serbisë, me qëndrime të përbashkëta e të fuqishme dhe koordinim ndërpartiak. “Çdo kalkulum për vota përmes temës së dialogut me Serbinë po bëhet në kurriz të Kosovës. Koha t'i themi mjaft më kësaj praktike të dëmshme. Këtë e do populli!”, ka shkruar Haradinaj-Stublla në “Facebook”.

Bordi i AKP-së vendos për shitje 31 asete të ndërmarrjeve shoqërore



PRISHTINË, 1 NËNTOR - Bordi i Drejtorëve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit ka mbajtur mbledhjen e radhës në të cilën ka marrë vendime të rëndësishme për procesin e privatizimit dhe të likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore në përputhje me mandatin e vet ligjor.

Në këtë takim Bordi shqyrtoi raportin mujor të menaxhmentit për periudhën paraprake duke përfshirë raportin mujor për ndërmarrjen shoqërore "Brezovica", e cila është nën administrim direkt.

Gjatë kësaj mbledhjeje Bordi shqyrtoi transaksionet e shitjes me tender publik përmes shitjeve të aseteve nr. 59, si dhe shqyrtoi dhe miratoi listën e

aseteve të ndërmarrjeve shoqërore në likuidim për vendosje në tender publik përmes shitjeve të aseteve nr. 61, e cila ka gjithsej 31 asete.

Bordi diskutoi dhe aprovoi planin për adresimin e rekomandimeve të Njësisë së Auditimit të Brendshëm 2017-2022, raportin e komisionit për shitjen e banesave, ku si rezultat i shtimit të punës së Komisionit për shitjen e banesave u miratuan raportet e shitjeve për 27 banesa. Gjithashtu, është aprovuar lista përfundimtare dhe shpërndarja e 20 për qind për NSh Enti i Teksteve dhe Mjeteve Mësimore dhe NSh Rilindja - Shërbimet e përbashkëta.

Në këtë takim Bordi miratoi

propozimin për dhënie të pëlqimit për qasjen në rrugë në parcelën nr. 09013-14 në Prizren, pronë e Ndërmarrjes së Pyjeve, ku do të ndërtohet objekti i ri i Gjykatës Themelore të Prizrenit. Gjatë kësaj mbledhjeje është shqyrtuar dhe miratuar edhe propozimi për dhënie të pëlqimit për regjistrim/bartje në librat kadastralë të ngastrës 501-34 ZK Malishevë, pronë e NSh "OPB Mirusha" në Malishevë, në përputhje me vendimin përfundimtar të Qeverisë së Kosovës për shpronësim me numër 16/89 të datës 20 korrik 2022, e shpronësuar për nevojat e Ministrisë së Punëve të Brendshme/Agjencisë së Regjistrimit Civil.

Kryeprokurori i Shtetit vlerëson mbështetjen e EULEX-it në trajtimin e rasteve të ndryshme penale



PRISHTINË, 1 NËNTOR - Ushtruesi i detyrës i kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, ka pritur në takim shefin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX), Lars-Gunnar Wigemark, i shoqëruar nga shefi i shtyllës së monitorimit, Benny Jensen dhe këshilltarja për të drejtat e njeriut në këtë mision,

Valentina Vitali.

Ushtruesi i detyrës i kryeprokurorit të Shtetit dhe shefi i EULEX-it patën diskutime të frytshme lidhur me çështjet që përfshijnë fushën e sundimit të ligjit, me theks të veçantë identifikimin dhe tejkalimin e sfidave të përbashkëta, avancimin e bashkëpunimit në funksion të konsolidimit të një

sistemi të drejtë ligjor, të arriturat dhe vështirësitë për trajtimin e rasteve të ndryshme penale që monitorohen nga misioni i EULEX-it si dhe shkëmbimin e pikëpamjeve për reformat ligjore, veçmas për hyrjen në fuqi të Kodit të Ri të Procedurës Penale.

Në këtë kontekst, u.d. kryeprokurori Kelmendi e vlerësoi jashtëzakonisht të domosdoshme

mbështetjen dhe ekspertizën e EULEX-it për ngritjen e efikasitetit gjatë trajtimit të rasteve të ndryshme penale. Po ashtu, u.d. kryeprokurori i Shtetit shprehi gatishmërinë institucionale për t'i adresuar të gjitha rekomandimet që dalin nga raportit monitorues i EULEX-it lidhur me punën e prokurorit të Shtetit, me këtë rast ka çmuar lart procesin e

monitorimit të rasteve të ndryshme penale, duke ndikuar kështu pozitivisht në avancimin e punës profesionale të prokurorëve të Shtetit. Në fund të dy bashkëbiseduesit e kanë vlerësuar këtë takim mjaft të dobishëm si dhe kanë shprehur gatishmërinë e ndërsjellë për thellimin e bashkëpunimit institucional edhe në të ardhmen.

Hamza vendos gurthemelin për ndërtimin e urës te Liqeni Akumulues në Mitrovicë

MITROVICË, 1 NËNTOR - Liqenit Akumulues në Mitrovicë po i shtohet edhe një urë e cila do të ketë pamje mjaft të bukur, gurthemelin e së cilës e vendosi të martën kryetari i komunës, Bedri Hamza. Fillimin e punimeve e përcollën nga afër edhe nënkryetari Arian Tahiri dhe drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe

Infrastrukturë, Granit Tmava. Ata e vlerësuan investim të rëndësishëm ndërtimin e urës, pasi ka qenë kërkesë e kamotshme e qytetarëve të Mitrovicës, duke e cilësuar vlerë e shtuar për atë zonë që frekuentohet edhe nga qytetarët e vendeve të tjera të Kosovës.

Vlera investive për realizimin e këtij projekti është 212

716.00 euro, ndërsa përfundimi i urës është paraparë të kryhet për tetë muaj e dhjetë ditë.

Projekti po realizohet falë memorandumit të mirëkuptimit në mes të komunës së Mitrovicës, Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe DEMOS-it.



Rreth 100 mijë shqiptarë në Luginë të Preshevës

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Të martën janë publikuar rezultatet e regjistrimit të popullsisë në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë.

Kryetari i Bujanocit, Nagip Arifi, ka bërë me dije se nga ky regjistrim del se Lugina e Preshevës ka rreth 100 mijë shqiptarë.

Në Preshevë dhe Bujanoc shumica e banorëve janë të

kombësisë shqiptare, përderisa në Medvegjë ka më shumë serbë. "Nga rezultatet preliminare që kemi siguruar mëngjesin e sotëm, Bujanoci numëron 54 498 banorë dhe 13 000 amvisëri, Presheva ka 59 24 banorë dhe 11 654 amvisëri, dhe Medvegja 8 459 banorë dhe 5 899 amvisëri. Këto shifra tregojnë se komuna e Bujanocit është komunë në rritje që, në krahasim me regjistrimin e fundit të rregullt në vitin 2001, komuna ka pasur gjithsej 43 302, sot është rritur për më shumë se

11 mijë banorë. Për gjithë këtë sukses fillimisht duhet ta falënderoj shefin e misionit të OSBE-së në Serbi, Jan Braathu, i cili ishte garantuesi më i madh që ky proces do të zhvillohet në frymën e standardeve evropiane, i cili më pastaj më hapi rrugën që të marr iniciativën për takime konsultative me përfaqësuesit e partive të tjera politike shqiptare në Luginë për t'iu përgjigjur pozitivisht regjistrimit. Pas tri takimeve konsultative në kabinetin tim, më 25 korrik 2022

nënshkruam deklaratën e përbashkët për të marrë pjesë në regjistrimin e popullsisë", ka deklaruar Arifi.

Ai ka thënë se ky numër i shqiptarëve në Luginë të Preshevës ka demantuar shifrat e regjistrimit të vitit 2011. "Vendimi për të dalë në këtë regjistrim nuk ishte i lehtë, pas bojkotit të vitit 2011, por në fund doli të jetë i drejtë. I drejtë, sepse demantuam shifrat e regjistrimit 2011, ku shqiptarët llogariteshin rreth 5 800 shqiptarë në gjithë

Serbinë. Tanimë duket qartë se numri i shqiptarëve është rreth 100 mijë. Dhe, në fund, por jo më pak të rëndësishëm, falënderoj të gjithë qytetarët që u regjistruan, grupin punues pranë administratës komunale, instruktorët që udhëhoqën këtë proces, si dhe një falënderim i posaçëm për të gjithë regjistruarit në terren, të cilët trokitën derë më derë përgjatë një muaji për të regjistruar çdo banor dhe çdo shtëpi apo banesë", ka theksuar Arifi.



Shëndetësia, arsimiti, mbrojtja e bujqësia vazhdojnë të jenë prioritetet e qeverisë



PRISHTINË, 1 NËNTOR - Buxheti i Kosovës për vitin 2023 do të jetë 3 miliardë e 212 milionë euro. Prej këtij buxheti janë ndarë 296 milionë euro për sektorin e shëndetësisë në nivel qendror e lokal dhe 60 milionë euro janë për barna esenciale për t'u siguruar që spitalet dhe qendrat e mjekësisë familjare janë mirë të furnizuara për të ofruar shërbime ndaj qytetarëve. Për këtë, po ashtu, do të shtohen edhe 400 pozita: 100 në nivel qendror, 300 në nivel lokal. Në arsim për vitin e ri buxhetor në përputhje me zotimet e qeverisë është paraparë ndërtimi i 11 çerdheve si dhe shtimi i 243 pozita të reja për staf dhe 500 asistentë për fëmijë me aftësi të kufizuara. Sa i përket fushës së bujqësisë, për

herë të parë buxheti për këtë fushë shkon në 87 milionë euro, që do të përkthehet direkt në ndihmën edhe më të madhe ndaj bujqve tanë dhe zhvillimin e këtij sektori jetik për vendin.

Vitin e kaluar është dyfishuar buxheti për Ushtrinë nga 50 milionë në 100 milionë, ndërkohë për vitin 2023 buxheti për fushën e mbrojtjes do të shkojë në 123 milionë euro, duke e ritur kështu mbështetjen për sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes.

Në vitin 2023 qeveria ka përmbytur premtimin e saj duke i përfshirë në skemë të gjithë fëmijët nën moshën 16-vjeçare. E për këtë qëllim është ndarë buxhet në vlerë prej 60 milionë eurosh.

Brenda një muaji arrestohen 97 persona të kërkuar nga gjykatat kompetente

Prishtinë, 1 nëntor - Policia e Kosovës në Pejë ka bërë me dije se nga 1 deri më 31 tetor ka realizuar 97 urdhëresa dhe fletarrestime të lëshuara nga

gjykatat kompetente. Personat e arrestuar për vepra të ndryshme penale janë dërguar në organet kompetente për të vazhduar

proceduarat e mëtutjeshme ligjore. "Njësitë relevante pranë Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë, në bashkëpunim me organet e

drejtësisë, në vazhdimësi do t'i realizojnë urdhëresat e lëshuara nga gjykatat kompetente", ka njoftuar policia.



Rizvanolli nuk e përjashton mundësinë e rritjes së çmimit të rrymës

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Ministrija e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, ka thënë se nuk përjashtohet mundësia e rritjes së çmimit të energjisë elektrike pas rënies së temperaturave. Rizvanolli gjatë raportimit në Komisionin për Ekonomi ka theksuar se sasia e peletit që prodhohet në Kosovë është e përballeshme për konsumin e brendshëm. "Siç e dini gjatë

muajve të verës disa njësi të termocentraleve kanë qenë në remont dhe për pasojë kapacitetet tona nuk kanë mundur ta mbulojnë kërkesën. Pas kësaj është marrë vendimi për shpalljen emergjente me rrymën. Duke qenë se situata nuk pritet të stabilizohet, mirëpo pritet që të vështirësohet gjatë muajve të dimrit, duke qenë se bien temperaturat e konsumi rritet, megjithëse gjatë dy javëve të fundit kemi parë një ulje të

çmimit në tregun evropian, por kjo do të jetë e përkohshme", ka thënë Rizvanolli. Po ashtu, ajo ka shtuar se sasia e peletit në vend është e përballeshme dhe se kjo do të ndikojë tek ata që e përdorin këtë lëndë për ngrohje. "Sasia e peletit që prodhohet është e përballeshme, por një pengesë ka qenë sigurimi i lëndës së parë, mirëpo pjesa që prodhohet në Kosovë mund të ndikojë në uljen e presionit në çmim dhe kjo mund të bëhet posaçërisht

me masat e jashtëzakonshme në treg që do të na mundësonin që ta vendosim një çmim tavan apo marzhë të fitimit. E kjo do të bënte që peleti që prodhohet në vend të mos shitet disa fish më shtrenjtë sesa kostoja e prodhimit, gjë që është duke ndodhur", është shprehur Rizvanolli, duke shtuar se kjo do të kishte ndikim të madh te qytetarët që shfrytëzojnë peletin apo që janë duke e konsideruar përdorimin e tij gjatë dimrit. Pa votat e opozitës, Komisioni

miratoi vendimin e qeverisë për zgjatjen e masave emergjente të furnizimit me energji elektrike. Me propozimin e LV-së, ky vendim do të shqyrtohet në seancën e 8 nëntorit. Komisioni, gjithashtu, miratoi Projektligjin së bashku me amendamentet për masat e përkohshme të produkteve bazike në raste të veçanta të destabilizimit në treg. Ky projektligj ishte miratuar në lexim të parë javën që shkoi në seancën e Kuvendit të Kosovës.



Kërkohet terminal i ri doganor në vendkalimin kufitar Jazhincë - Gllaboçicë

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Afaristët shqiptarë të Maqedonisë së Veriut po kërkojnë hapjen e një terminali doganor në vendkalimin kufitar në Jazhincë - Gllaboçicë, që do ta shkurronte kohën e eksportimit të mallrave në Kosovë. Afaristi tetovar Kasam Zendeli, i cili për më shumë se dhjetë vjet eksporton prodhime të qumështit në Kosovë, thotë se hapja e një terminali doganor në vendkalimin kufitar Jazhincë - Gllaboçicë do ta shkurronte kohën e eksportimit të mallit në Kosovë. "Ky veprim do të ishte i



mirëseardhur sepse do ta shkurronte kohën e vajtjes së mallit nga Tetova deri në Prishtinë. Momentalisht për ta

dërguar një kamion me mall deri në Prishtinë shkon 9 deri në 10 orë, me pritjet e gjata që bëhen në terminalin e Bllacës", ka theksuar Zendeli. Hapjen e këtij terminali e kërkon edhe Oda Ekonomike e Maqedonisë Veri Perëndimore. Drejtuesit e saj vlerësojnë se hapja e një terminali të përbashkët doganor do ta lehtësonte punën e bizneseve dhe do të kishte ndikim pozitiv për ekonominë e të dyja shteteve. "Duke pasur parasysh se krejt malli me Kosovën qarkullon vetëm me një pikë

doganore, ne vendosëm që ta bëjmë një kërkesë e cila nuk mbështetet nga infrastruktura e duhur për një terminal doganor, por që do ta lehtësonte punën e bizneseve nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Ndërkohë doli në ndihmë Qeveria e Kosovës, se terminalin doganor e bëjmë të përbashkët. Ajo na konvenonte, sepse me një terminal doganor kryhen të dy veprimet", ka thënë për RTK-në Menderes Kuçi, kryetar i Kuvendit të Odës Ekonomike të Maqedonisë Veri Perëndimore.

Komisioni për Ekonomi miraton Projektligjin për vendosjen e çmimeve tavan në produktet bazike

Prishtinë, 1 nëntor - Komisioni parlamentar për Ekonomi ka miratuar Projektligjin së bashku me

amendamentet për masat e përkohshme të produkteve bazike në raste të veçanta të destabilizimit në treg. Ky

projektligj ishte miratuar në lexim të parë javën që shkoi në seancën e Kuvendit të Kosovës dhe është caktuar që

me procedura të përsheptuara, në një seancë të re, më 8 nëntor, të shqyrtohet në lexim të dytë.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

PSG-ja dhe Benfica kërkojnë vendin e parë në grup



Paris Saint Germain dhe Benfica kanë grumbulluar nga 11 pikë në Grupin H dhe sonte shpresojnë që njëra prej tyre të gabojnë dhe të sigurojnë pozitën e parë. PSG-ja ka përballje me të vështirë, pasi ballafaqohet në Torino me Juventusin. Në ndeshjen tjetër portugezët e Benficës përballen me Maccabi Haifa

“Epoka e re”

TORINO, 1 NËNTOR - Juventusit sonte (e mërkurë) e zhvillon ndeshjen e fundit në fazën e grupeve për këtë edicion në Ligën e Kampionëve ndaj Paris Saint-Germain. Paraqitja e “Zonjës së Vjetër” në kompeticionin më të rëndësishëm në futboll ka qenë zhgënjyese. Skuadra e Massimiliano Allegrit ka vetëm tri pikë të grumbulluara dhe rrezikon pjesëmarrjen edhe në Ligën e Evropës nëse pëson humbje nga PSG-ja ose nëse fiton Maccabi Haifa ose barazon ndaj Benficas. Kjo e fundit është në garë për vendin e parë në Grupin H me skuadrën e PSG-së. Vendimtare në eliminimin e Juves nga Liga e Kampionëve ishte përballja ndaj Benficës, të cilën e fituan portugezët me rezultat 4-1.

Nga edicioni 2013-14 Juventusit nuk e ka kaluar fazën e grupeve, por Allegri vazhdon ta ruajë besimin e drejtuesve të klubit nga Torino, derisa e mira e saj është se ka fituar tri

Formacionet e mundshme:

Juventus: Szczesny; Bonucci, Gatti, Sandro; Cuadrado, Rabiot, Locatelli, Miretti, Kostiq; Kean, Milik.

Paris Saint-Germain: Donnarumma; Hakimi, Marquinhos, Ramos, Mendes; Soler, Verratti, Ruiz; Sarabia, Mbappe, Messi.

ndeshjet e fundit në Serinë A. “Ne do të duhet të luajmë një ndeshje inteligjente, teknikisht të vlefshme. Në Paris kemi dhënë dy gola, në dy situata të ngjashme. Ne do të kemi nevojë për besim siç kishim në Lecce, në funksion të asaj që do të bëjmë nesër mbrëma”, ka thënë Allegri.

Ndërsa kampionia e Francës ka fituar ndeshjet e fundit si në Ligën e Kampionëve ashtu edhe në La Liga, derisa sonte synon të marrë fitore dhe të kualifikohet si e para në grup. Paul Pogba, Dusan Vlahovic, McKennie Matias Soule, Marley Ake, Leandro Paredes, Angel Di Maria, Gleison Bremer, Mattia De Sciglio, Federico Chiesa,

Gjumnastet përfaqësojnë Kosovën në Portugali

PRISHTINË, 1 NËNTOR - Sportistët nga Kosova janë nisur të martën drejt Portugalisë. Ato do të marrin pjesë “GAIA IT WAG International Tournament 2022”. Gara në gjumnastikë do të mbahet më 5 dhe 6 nëntor. Në mesin e shumë shteteve do të jetë edhe Kosova. Kosova në këto gara do të përfaqësohet nga tetë sportiste, në mesin e tyre janë edhe motrat Lisa e Vilza Zeqiri, Bora Hoti, Valëza Rama, Fitore Rudari, Una Kajtazi, Elena Sefa dhe Riana Fejzullahu. Sportistët nga Kosova do të jenë të shoqëruara nga Shkumbin Maqestena dhe Abeliana Bregu. Vashat nga Kosova do të qëndrojnë në Portugali nga 1 nëntor deri më 7 nëntor. Ato janë mbështetur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MRKS).



SHKURT

Rina Rexhepi rikthehet te Kosova

Rina Rexhepi është kthyer pas një kohe të gjatë në Përfaqësuesen e Kosovës në hendboll. Ajo ka kaluar formë shumë të mirë në muajt e fundit në Ligën B të Danimarkës dhe shquhet për numrin e madh të golave që i shënon për skuadrën AGF Handbold. Aktualisht është në mesin e dhjetë golashënuesve më të mira në ligën ku luan. Në pesë ndeshje Rina i ka shënuar 35 gola. Pra ka mesatare shumë të mirë të golave për ndeshje. Rina do të jetë armë shtesë në ndeshjet e Kosovës ndaj Ishujve Faroe. Ndeshjet me Ishujt Faroe i takojnë fazës së parë kualifikuese për Botërorin 2023. Ndeshja e parë është të enjten në Istog, ndërsa e dyta të shtunën po në Istog.

Mallorca e shet Muriqin vetëm për 40 milionë euro

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, pas paraqitjeve të shkëlqyeshme në këtë fillimsezon, e ka rritur dukshëm vlerën e kartonit të tij. Skuadra e Mallorcas ua ka bërë të qartë ndërmjetësuesve të saj se do ta shiste sulmuesin “dardan” vetëm për 40 milionë euro. 28-vjeçari i ka realizuar 6 gola nga 10 golat sa i ka shënuar krejt ekipi, më saktësisht 60 për qind të golave. Ai është golashënuesi i katërt më i mirë në kampionatin spanjoll, duke i lënë prapa yjet si Benzema, Griezmann, Morata e Cavani. Mallorca synon ta mbajë ish-futbollistin e Lazios, Rizesporit dhe Fenerbahçes për një kohë të gjatë.

Hyseni rikthehet së shpejti, Pefqeli mungon deri në pesë javë

FC Prishtina në javët e fundit është përballur edhe me lëndime të futbollistëve. Mesfushori me tipare sulmuese Hasan Hyseni në ndeshjen me Malishevën, të zhvilluar më 14 shtator, e ka këputur ligamentin e jashtëm laterial, ndërkohë që shërimi është duke shkuar shumë mirë. Hyseni ditët e fundit është stërvitur teksa javën që vjen do ta bëjë edhe një rezonancë, më pas pritet që t'i bashkohet ekipit në përgatitje. Ndërkohë, së fundmi, në përgatitje është lënduar edhe mesfushori Mërgim Pefqeli. Ai i ka dëmtuar tre ligamente të njëjës së këmbës dhe pas kontrolleve të kryera rezulton se do të mungojë 3 deri në 5 javë.

GRUPI E	
21:00 Milan - Salzburg	
21:00 Chelsea - Dinamo Zagreb	
Tabela	
	Pikë
1. Chelsea	10
2. Milan	7
3. Salzburg	6
4. Dinamo Zagreb	4
GRUPI F	
18:45 Real Madrid - Celtic	
18:45 Shakhtar Donetsk - Leipzig	
Tabela	
	Pikë
1. Real Madrid	10
2. Leipzig	9
3. Shakhtar Donetsk	6
4. Celtic	2
GRUPI G	
21:00 Copenhagen - Borussia Dortmund	
21:00 Manchester City - Sevilla	
Tabela	
	Pikë
1. Manchester City	11
2. Borussia Dortmund	8
3. Sevilla	5
4. Copenhagen	2
GRUPI H	
21:00 Juventus - Paris Saint-Germain	
21:00 Maccabi Haifa - Benfica	
Tabela	
	Pikë
1. Paris Saint-Germain	11
2. Benfica	11
3. Juventus	3
4. Maccabi Haifa	3

Samuel Iling-Junior dhe Kaio Jorge janë mungesat e Juventusit në këtë ndeshje, në anën tjetër PSG-ja do të jetë pa Presnel Kimpembe, Keylor Navas dhe Neymar. Në Grupin E Chelsea e ka siguruar vendin e parë në grup me 10 pikë nga pesë ndeshje, ndërsa Milanit i mjafton një pikë nga përballja me Salzburgun për ta siguruar vendin e dytë në grup.

Sejdiu, afër marrëveshjes me Phoenixin

PEJË, 1 NËNTOR - Trajneri Gani Sejdiu është afër marrëveshjes me skuadrën nga Banja e Pejës, Phoenix. "Timonieri" nga Mitrovica e ka konfirmuar lajmin në një prononcim për "Shqip.com".

"Jemi në negociata tash e një kohë. Bisedat janë duke shkuar shumë mirë dhe të presim se si do të përfundojnë. Unë tash e një kohë jam afër ekipit duke e përcjell nga afër në mënyrë që

të marr sa më shumë informacione. Projekti i klubit është shumë serioz dhe po më pëlqen. Pas përfundimit të dy xhirove në Ligën e Parë do ta marrim së bashku një vendim përfundimtar", ka

thënë Gani Sejdiu. Phoenix bën pjesë në Grupin A të Ligës së Parë. Pas xhiros së 12 ndodhet në pozitën e tretë me 22 pikë, aq sa ka edhe Istogu. Tabelës i prin Feronikeli 74 me 25 pikë.



Bekaj: Ky është viti im i fundit te Tirana, dua një transferim jashtë

TIRANË, 1 NËNTOR - Visar Bekaj, portieri i Tiranës, ishte pjesë e emisionit "Koha shtesë", ku foli për pozitën e tij te Përfaqësuesja e Kosovës dhe për skuadrën e Tiranës. Tirana momentalisht pozicionohet e dyta me 18 pikë në tabelën e Kategorisë Superiore në Shqipëri, vetëm 1 pikë larg rivalit të saj, Partizanit. Me suksesin përballë një rivali tjetër në formën e skuadrës së Kukësit, është e qartë se Tirana mendon që sërish të luftojë për titullin e kampionit. Dhe me Bekajn në portë deri më tani ka pësuar vetëm 8 gola duke pasur mbrojtjen e dytë më të fortë në Shqipëri. I pyetur për periudhën e tij që po kalon te Tirana, Bekaj u përgjigj: "Do të jetë kampionat i vështirë, por do të jemi mes më të mirëve, te Tirana kam gjetur profesionalizëm dhe infrastrukturë më të mirë, por më shumë ka cilësi kampionati i Kosovës". Por a do të ketë hapësirë te Kosova. Lidhur me këtë pyetje Bekaj u përgjigj: "Shpresoj të jem pjesë dhe të kem mundësi. Ndonjëherë mërzitem kur trajnerët nuk më dhurojnë



mundësinë, por unë duhet të vazhdoj që të punoj dhe shpresoj ta arrij qëllimin tim". Ai, gjithashtu, foli edhe për situatën e kontratës së tij te Tirana, duke thënë se do t'i shikojë mundësitë që ka dhe të shohë që ndoshta të transferohet jashtë: "Është viti im i fundit te Tirana dhe si lojtar i lirë synoj të transferohem jashtë, pasi që kontrata ime të skadojë në qershor". I pyetur se a ka diskutuar me trajnerin e Kosovës, Alain

Giresse, për pozitën e tij te "Dardanët", Bekaj ka deklaruar se nuk ka komunikuar me të, por se do të shohë se çfarë do të vendosë e do të veprojë. "Nuk kam pasur bisedë me të. Shpresoj ta ketë mirë, por nuk kam ide se si do të veprojë ai. Kosova më ka bërë burrë dhe ky është vendi im dhe nuk ia kthej shpinën Kosovës. Për Shqipërinë kam shumë respekt, por zemra ime rreh për Kosovën", ka shtuar Bekaj.

Milwaukee ende i pathyeshëm, fitojnë clippersat dhe Utah Jazzi

MILWAUKEE, 1 NËNTOR - Milwaukee vijon të jetë skuadra e vetme pa asnjë humbje këtë sezon në NBA. Ekipi i Bucksit mposhti me rezultat 110-108 Detroitin në një ndeshje që dhuroi mjaft emocione deri në sekondën e fundit. Tjetër ndeshje magjike për Antetokounmpo, autor i 31 pikëve, mbështetur edhe nga Holiday me 25 pikë e Lopezi me 24 pikë. Rikthehet te fitorja Brooklyn, që mposhti me rezultat 116-109 Indianan, sfidë ku për vendasit u dalluan Duranti me 36 pikë e Irvingu me 28 pikë. Për miqtë, Duarte realizoi 30 pikë, por që mbetën për statistikë. Fitore në sekondën e fundit korrën edhe clippersat, që mundën me shifrat 95-93 Houstonin, ndeshje ku Paul George realizoi 35 pikë, raporton "Telesport". Në Perëndim, skuadra e Utah Jazzit është e vetmja me gjashtë fitore, duke mposhtur Memphisin (121-105). Markkanen me 31 pikë ishte lider në fushë për Jazzin, duke i bërë të pavlefshme 37 pikët e Morantit. Pa probleme fitoi skuadra e Torontos, që mundi Atlantian me rezultat 139-109, ku u dallua Siakam me 31 pikë e 12 rebounde.



REZULTATET

Charlotte - Sacramento	108-115
Washington - Philadelphia	111-118
Brooklyn - Indiana	116-109
Toronto - Atlanta	139-109
Milwaukee - Detroit	110-108
Utah Jazz - Memphis	121-105
Clippers - Houston	95-93

SHKURT

Di Biagio pritet të jetë trajneri i ardhshëm i Shqipërisë

Luigi Di Biagio do të jetë trajner i ardhshëm i Kombëtares së Shqipërisë në futboll. "Sportitalia" e konsideron këtë lajm ekskluziv dhe tekniku pritet ta mbyllë marrëveshjen shumë shpejt me Federatën Shqiptare. Tekniku kishte marrë një ofertë nga Cosenza, por ka pëlqyer aventurën shqiptare. Sipas "Sportitalia"-s, kontaktet ndërmjet trajnerin italian dhe drejtuesve të FShF-së kanë vazhduar prej javësh dhe tani kanë gjetur gjuhën e përbashkët edhe sa i përket aspektit financiar, që ende nuk është bërë publike. Di Biagio e nisi aventurën si trajner me Italinë U-21 në mars të vitit 2018 dhe përfundoi mbas një viti. Aventura e fundit e Di Biagio në krye të një skuadre ishte ajo me Spalin e cila përfundoi në vitin 2020.

Verstappen: Nuk e kisha menduar kurrë se do ta thyjeja rekordin e Schumacherit

Piloti holandez Max Verstappen të dielën në garën e Meksikës korri fitoren e 14-t sezonale në Formula 1. Ai theu rekordin e 13 fitoreve që mbahej nga dy legjenda, si Michael Schumacher e Sebastian Vettel. Natyrisht me më pak gara përgjatë një sezoni sesa sot. Gjithsesi, 14 fitore në 20 gara të zhvilluara deri më tani është një arritje e jashtëzakonshme e Verstappenit. "Nuk kisha menduar kurrë se do të fitoja 14 gara brenda një viti. Natyrisht që jam shumë krenar. Kam 416 pikë dhe shpresoj të fitoj të tjera pikë e gara", ka thënë holandezi i Red Bullit. "Në fund të fundit, ajo që ka rëndësi është ta fitoj titullin dhe ia dola mbanë. Kur nisi ky sezon kishim shumë dyshime, por tani kam 100 % besim te makina, pasi e di forcën e saj. Nuk kam pasur kurrë frikë nga Mercedesi apo Ferrari. Edhe gara e fundit në Meksikë e konfirmoi dominimin tonë", u shpreh Verstappen.

Koulibaly: Kurrë nuk mund ta vesh fanellën e Juventusit

Kalidou Koulibaly është rikthyer për të folur rreth prapaskenës së transferimit të tij. Para se të kalonte te Chelsea, ai kërkohej nga disa ekipe të tjera, ndër to edhe Juventusit. "Kisha oferta nga shumë klube, por zgjodha me kujdes. A më kërkoi Juventusit? Po, paraqiti një ofertë për mua, një kontratë, por unë nuk mund ta pranoja. Nuk do ta vishja kurrë fanellën e tij, sidomos nga respekti që kam për Napolin", është shprehur mbrojtësi i Chelsea për "Corsera".

Marquez: Ky është sezoni më i tmerrshëm i karrierës time

Viti 2022 është për t'u harruar për motorin Hondas, pasi është skuadra e vetme që nuk ka arritur asnjë fitore në MotoGP. Vetëm Marc Marquez është munduar ta mbajë gjallë motorin japonez, por kjo është shumë pak për një skuadër që synon të duelojë për titullin. "Nuk jam aspak i kënaqur, jo vetëm unë, por e gjithë skuadra. E vetmja gjë që duhet të bëjmë është të përmirësohemi dhe të jemi më kompetitivë vitin tjetër. Kjo është një sfidë për të gjithë ne", u shpreh Marquez, 8 herë kampion bote në garat e motoçiklizmit. "Motori ynë nuk po ecën ashtu sikurse ne dëshirojmë. Nuk e fshehim që po punojmë për vitin 2023, që të jemi njësoj si Ducati, të paktën në garë. Personalisht ky mbetet një vit i tmerrshëm, kushtëzuar edhe nga operacioni në krah, që më la jashtë piste disa muaj. Po përmirësohemi, por duhet më shumë këmbëngulje nga të gjithë", ka deklaruar spanjollin e Hondas, Marc Marquez.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Lokaj Solar" Sh.p.kPrilep, Deçan, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin fotovoltaiik 12 MW në Rastavicë komuna e Deçanit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.11.2022 në ora 10:00 në hapësirat e restorant "Tropikal" rruga "Dëshmorët e Kombit" pa Nr. përball QKMFs "Adem Ukhaxhaj" Deçando të organizohet debat publik nga Kompania "Lokaj Solar" Sh.p.kPrilep, Deçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin fotovoltaiik 12 MW në Rastavicë komuna e Deçanit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/74978664293?pwd=b3lPaTVISGFHUGhEWwtkbWhsUksrdz09>

Meeting ID: 749 7866 4293

Passcode: FhBsV6

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Lokaj Solar" Sh.p.kPrilep, Deçan për impiantin fotovoltaiik 12 MW në Rastavicë komuna e Deçanit.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Kompania Regionale e Mbeturinave K.R.M."Uniteti"SH.A.

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

Kompania Regionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Tre (3) Punëtor Fizik - KRM "Uniteti" Sh.A Njësia në Vushtrri - i Konkursit të rishpallur me datë 05.10.2022

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej dates **02.11.2022**. deri me date **08.11.2022** ora 16:00.

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M"Uniteti"Sh.A.-Mitrovicë

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Lokaj Solar" Sh.p.kPrilep, Deçan, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin fotovoltaiik 20 MW në Prilep komuna e Deçanit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 30.11.2022 në ora 10:30 në hapësirat e restorant "Tropikal" rruga "Dëshmorët e Kombit" pa Nr. përball QKMFs "Adem Ukhaxhaj" Deçando të organizohet debat publik nga Kompania "Lokaj Solar" Sh.p.kPrilep, Deçan, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për impiantin fotovoltaiik 20 MW në Prilep komuna e Deçanit.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/74978664293?pwd=b3lPaTVISGFHUGhEWwtkbWhsUksrdz09>

Meeting ID: 749 7866 4293

Passcode: FhBsV6

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Lokaj Solar" Sh.p.kPrilep, Deçan për impiantin fotovoltaiik 20 MW në Prilep komuna e Deçanit.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.



Kompania Regionale e Mbeturinave K.R.M."Uniteti"SH.A.

NJOFTIM PËR VAZHDIMIN E AFATIT TË KONKURSIT

Kompania Regionale e Mbeturinave "Uniteti" Sh.A zgjatë afatin edhe për shtatë (7) ditë kalendarike për aplikim të kandidatëve për pozitën :

Një (1) Punëtor Fizik - KRM "Uniteti" Sh.A Njësia në Skenderaj - i Konkursit të rishpallur me datë 05.10.2022

Për arsye se nuk është arritur numri i duhur i aplikacioneve.

Afati i konkurimit vazhdohet prej dates **02.11.2022**. deri me datë **08.11.2022** ora 16:00.

Vërejtje: Kandidatët që kanë aplikuar më herët në këtë pozitë të punës, nuk kanë nevojë të aplikojnë përsëri. Formularin zyrtar për aplikim dhe informata tjera shtesë mund ta gjeni në zyrën e Arkivës pranë K.R.M"Uniteti"Sh.A.-Mitrovicë



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021); lidhur me nenin 41 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2022 (i ndryshuar/plotësuar), si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr. 2216 të datës 27.10.2022 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS për plotësimin e vendit të lirë të punës

1. Pozita:	Zyrtar për softuer dhe harduer
Numri i referencës:	ZSH/ZKA/22-10/22
Grada:	ZKA-C4
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit:	Me kohë të pacaktuar

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Udhëheq të gjitha projektet që ndërlihen me infrastrukturën e harduerëve dhe softuerëve, duke përfshirë projektimet teknike, zbatimin e proceseve të tjera teknike dhe konfigurimi i tyre;
- Siguron përkrahje të softuer-it për aplikacionet standarde dhe ofron përkrahje për sistemet operative;
- Analiza dhe hartimi i specifikave për përmirësimin e mëtutjeshme të sistemeve harduerike dhe softuerike sipas kërkesave teknike dhe nevojave të organizatës;
- Bashkëpunimi i ngushtë me administratorët nga stafi i IT për të siguruar se sistemet janë funksionale dhe të sigurta gjatë tërë kohës;
- Instaloni, montoni dhe konfiguroni kompjuterët, monitorët, telefonat, infrastrukturën e rrjetit dhe periferiket si printerët , skanerët.
- Zgjidh problemet në sistemin e kompjuterëve, duke përfshirë problemet e harduer-it, e-mail, problemet e pajisjeve të rrjetit dhe pajisjeve periferike, riparoni dhe korrigjoni problemet e paraqitura;
- Bashkëpunoni me zyrtarin për administrimin e rrjetit për konfigurimin, mirëmbajtjen dhe migrimin e serverëve;
- Vepron si burim teknik duke i ndihmuar shfrytëzuesit për t'i zgjidhur problemet me pajisje dhe në të dhëna;
- Kryen edhe detyra të tjera sipas kërkesës nga mbikëqyrësi.

Kualifikimet themelore:

- Diplomë fakulteti;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale;
- Preferohet certifikim nga fusha e Teknologjisë së Informacionit.

Shkathësitë e kërkuara:

- Njohuri dhe përvojë në fushën e zhvillimit dhe administrimit të teknologjisë së Informacionit;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme lidhur me teknologjinë e Informacionit;
- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës;
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave;
- Njohuri të mira të menaxhimit të projekteve dhe të vlerësimit të ndikimit të projekteve
- Aftësi për përmbyllje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point, Internet).
- Njohuri të mira të gjuhës angleze.

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Kompensimi i pagës për pozitat e shpallura bëhet në përputhje me rregullat e brendshme të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë;
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 17.11.2022 ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

U skladu sa Članom 15.2 Zakona Br. 05/L-055 o Generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji revizije Republike Kosovo, kao i Članom 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 ZA o Prijemu i Karjeru u Nacionalnoj kancelariji revizije (objavljeno u Službenom listu 16.09.2021), vezano za Član 41 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji radnih mesta, Godišnjem planu zapošljavanja kao i Odluci Generalne revizorke sa Br. 2216 datuma 27.10.2022 o popunjavanju slobodnog radnog mesta, Nacionalna kancelarija revizije objavljuje:

KONKURS za popunjavanje slobodnog radnog mesta

1. Pozicija:	Zvaničnik za softver i hardver
Broj reference:	ZSH/ZKA/22-10/22
Koeficijent:	ZKA-C4
Broj pozicija:	Jedna (1)
Trajanje imenovanja:	Na neodređeno vreme

Dužnosti i odgovornosti:

- Vodi sve projekte koji se vežu sa infrastrukturom hardvera i softvera, obuhvatajući tehničke projekcije, sprovođenje drugih tehničkih procesa i njihovom konfiguracijom;
- Obezbeđuje podršku softvera za standardne aplikacije i nudi podršku za operativne sisteme;
- Analiza i izrada specifikacija za dalja unapređenja hardverskih i softverskih prema tehničkim zahtevima i potrebama organizacije;
- Bliska saradnja sa administratorima iz IT osoblja kako bi se obezbedili funkcionalni sistemi tokom celog vremena;
- Instalira, montira i konfigurise kompjutere, monitore, telefone, infrastrukturu mreže i periferne kao što su štampači, skeneri;
- Rešava probleme u sistemu kompjutera, obuhvatajući probleme sa hardverom, mejlom, probleme mrežne opreme i periferne opreme, popravlja i koriguje postojeće probleme;
- Saraduje sa zvaničnikom za administraciju mreže o konfiguraciji, održavanju i migraciji servera;
- Deluje kao tehnički izvor i pomaže korisniku da rešava probleme sa opremom i podacima;
- Obavlja i druge poslove na zahtev nadzornika.

Osnovne kvalifikacije:

- Diploma fakulteta;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva;
- Poželjna sertifikacija iz oblasti Informacione tehnologije.

Potrebne veštine:

- Znanje i iskustvo u oblasti razvoja i administracije informacione tehnologije;
- Poznavanje važećih pravnih akata vezano za informacionu tehnologiju;
- Veštine u komunikaciji i planiranju rada;
- Istraživačke, analitičke, ocenjivačke veštine i formulacija preporuka i saveta;
- Dobro poznavanje upravljanja projektima i procene uticaja projekata;
- Sposobnost ispunjavanja zadataka i poslova pod pritiskom
- Poznavanje rada na kompjuteru aplikacija programa (Word, Excel, Power Point, Internet).
- Dobro poznavanje engleskog jezika.

Opšte informacije za kandidate:

Naknada plate za objavljene položaje vrši se u skladu sa internim pravilima rada Nacionalne Kancelarije Revizije.

Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu

Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za apliciranje;
- kopiju lične karte Republike Kosova;
- dokaze o školskoj spremi i radnom iskustvu;
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravnosnažnom odlukom;
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (onlajn) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, zadnji rok za podnošenje dokumentacije 17.11.2022.godine do 16.00 časova.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi www.zka-rks.org i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na rekrutimi@oagks.org ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručjenju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

